



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 998  
Datë: 12/2/2024

Mbështetur në nenin 17 të Kodit të Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës (Nr. 1/751, dt. 19/07/2013), Rregullave të punës të Këshillit të Etikës, nr. 1/629, datë 14.07.2016, Rregullores për Masat dhe Procedurat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës dhe Rregulloren e Punës të Këshillit të Etikës (Nr. 857, datë 14.07.2016) si dhe Statutin e Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Etikës, njëzëri, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.02.2024 mori këtë:

**VENDIM**

- I. Këshilli i Etikës konstaton se ka të drejtën dhe detyrimin e nxjerrjes së vendimeve me përbajtje vërtetimi dhe konstatimi të gjendjeve juridike dhe faktike, duke iu referuar lëndës së referuar me nr. 01/2/855, datë 03.07.2023.
- II. Këshilli i Etikës, duke u bazuar në deklaratën e Universitetit të Romës "La Sapienza" të Italisë dhe diplomën e prezantuar, konfirmon vërtetësinë e përfundimit të studimeve të doktoratës në Universitetin e Romës nga ana e Prof. Asoc. Dr. Avni Puka.
- III. Këshilli i Etikës, duke u bazuar në raportin e ekspertizës profesionale, konstaton origjinalitetin e punimit të doktoratës të Prof. Asoc. Dr. Avni Puka me titull: "Përgjegjësia penale e personave juridikë", të mbrojtur me datën 08.09.2016, pranë Fakultetit Juridik, Universitetit te Prishtinës.
- IV. Këshilli i Etikës, duke u bazuar në përgjigjen e Agjencisë Kosovare të Akreditimit dhe organeve kompetente të Universitetit, konfirmon respektimin e kornizës normative dhe standardeve akademike në procedurën për avancimin akademik të Prof. Asoc. Dr. Avni Puka.

**Arsyetim**

**I. Gjendja faktike**

Me datë 03. 07. 2023, Këshilli i Etikës të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka pranuar një Kërkesë nga Prof. Asoc.Dr.Ajni Puka Dekan i Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës (Kërkesa Nr.prot.2/855, dt.3.7.2023).

Përmes kësaj shkrese, Prof.Asoc.Dr.Avni Puka i është drejtuar Këshillit te Etikës në UP, që të marr në shqyrtim dhe vlerësoj akuzat dhe pretendimet kundrejt tij ne lidhje me:

- *originalitetin e punimit të Doktoratës, me titull: "Përgjegjësia penale e personave juridikë", te mbrojtur me datën 08.09.2016, pranë Fakultetit Juridik, Universitetit te Prishtinës;*
- *vërtetësinë e përfundimit të studimeve të doktoratës ne Universitetin e Romës "La Sapienza" (Itali); dhe*
- *avancimin akademik, konkretisht bazën juridike për fitimin e titujve dhe verifikimin e te gjitha faktave në lidhje me këtë proces.*

Shkaku dhe interesi juridik i kësaj shkrese ishte se me datën 24.10.2022, në disa media elektronike janë qarkulluar lajme se punimi i Doktoratës nuk është original dhe përmban elemente të plagiaturës. Në lidhje me këto fakte, janë paraqitur dhe deklarime/kundërshtime publike nga Pala parashtruese Prof.Asoc.Dr. Avni Puka, duke i hedhur si poshtë si shpifje të ulëta. Po ashtu, Prof. Asoc.Dr.Avni Puka pohon se, Disertacioni i Doktoratës i mbrojtur ne UP në vitin 2016 është dorëzuar në UP me rastin e mbrojtjes së Disertacionit në vitin 2016; po i njëjti, pa asnje ndryshim është publikuar në formë monografie, e më vone pa asnje ndryshim është ngarkuar edhe në E-Akreditimi/Agjencia e Akreditimit.

Me datën 19.06.2023 janë qarkulluar në media përsëri lajme se Prof.asoc.Dr.Avni Puka nuk ka të kryer doktoratë në Itali, përkatesisht në Universitetin e Romës La Sapienza. Edhe në lidhje me këtë, me date 21.06.2023 pala parashtruese Prof.Asoc.Dr.Avni Puka përmes mediave ka reaguar publikisht duke e bërë publike diplomën e Doktoratës të lëshuar nga ky Universitet.

Kërkesës në fjalë të paraqitur pranë Këshillit të Etikës i janë bashkangjitur:

- Punimi e Doktoratës për vlerësim të originalitetit;
- Diploma e Doktoratës të Universitetit të Prishtinës;
- Diploma e Doktoratës së Universitetit të Romës "La Sapienza" dhe
- Raporti i Komisionit vlerësues Nr.10/58 datë 02/06/2022.

## II. Gjendja juridike dhe provat

Këshilli i Etikës në pajtim me Kodin e Etikës të Universitetit të Prishtinës (neni 13 – Përgjegjësia ndaj Universitetit) rivlerëson se stafi akademik i promovon vlerat njerëzore, reputacionin e profesionit dhe të komunitetit akademik përmes deklaratave dhe veprimeve publike, që e ruajnë integritetin dhe dinjitetin e Universitetit. Në të njëjtën kohë dhe në pajtim me këtë postulat, rivlerëson se lajmet e tillë të shfaqura në media për një staf akademik të këtij Universiteti dëmtojnë rëndë reputacionin e Universitetit dhe sidomos të vet personelit akademik individualisht.

Mbi këtë bazë, Këshilli i Etikës në mënyrë unanime ka vendosur që kjo Kërkesë të shqyrtohet hollësisht. Këshilli Etikës lidhur më këtë ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe autorizuar organet menaxhuese të Universitetit, e përmës kësaj edhe autoritetet tjera jashtë UP-së, që të ndërmarrin veprime konkrete për të verifikuar të gjitha faktet dhe pretendimet kundrejt palës parashtruese, si: 1. në lidhje me diplomën dhe përfundimin e studimeve të doktoratës të kandidatit Avni Puka pranë Universitetit të Romës La Sapienza në Itali; 2. originalitetin e

Disertacionit të Doktoratës të mbrojtur në Universitetin e Prishtinës, dhe 3. verifikimin e te gjitha faktave në lidhje me procesin e avancimit akademik të Avni Puka.

Në në lidhje me diplomën dhe përfundimin e studimeve të doktoratës të kandidatit Avni Puka në Universitetin e Romës La Sapienza, Këshilli i Etikës ka autorizuar menaxhmentin e UP që të ti drejtohen formalisht instancave të Universitetit La Sapienza.

Në origjinalin e shkresës (përgjigjës) se Universitetit Sapienza të Romës (*Sapienza Università di Roma, Settore Dottorato di ricerca - corsi e carriere (Ph.D. Office)*), në lidhje me diplomën dhe përfundimin e studimeve të doktoratës së kandidatit Avni Puka konfirmohet si në vijim:

*"Our records certify that as of this date:*

*AVNI PUKA, ID number 1525691, Kosovar citizen, born in ISTOG (KOSOVO) on 21.07.1983, who was admitted to the three-year PhD Programme in DIRITTO PUBBLICO [DOTT] - Curriculum DIRITTO E PROCEDURA PENALE (28th cycle) held at Sapienza University, successfully passed the final exam and was awarded the Doctor of Philosophy degree on 21.09.2017. The candidate defended a final dissertation with italian title.*

*PhD Classification/Level: Third Cycle QF-EHEA – EQF/ISCED 2011 Level 8.*

*We also confirm the veracity of the "PERGAMENA" with protocol number 13969 issued by this University."*

Nga kjo kuptohet se, Avni Puka me numër ID 1525691, shtetas kosovar, i lindur në ISTOG (KOSOVË) më 21.07.1983, është pranuar në programin e doktoratës trevjeçare në të "DREJTEN PUBLIKE"-Kurrikula E DREJTË DHE PROCEDURË PENALE (Cikli 28), të organizuar nga Universiteti Sapienza, ka kaluar me sukses provimin përfundimtar dhe i është dhënë titulli i Doktor (Doctor of Philosophy) më datë 21.09.2017. Gjithashtu në ketë shkresë theksohet se kandidati ka mbrojtur disertacionin përfundimtar me titull italian, dhe se niveli i doktoratës/klasifikimi është: Cikli i Tretë QF-EHEA – EQF/ISCED 2011, Niveli 8. Në ketë shkresë të Universitetit të Romës "La Sapienza" konfirmohet vërtetësia e Diplomës (PERGAMENËS) me nr. prot. 13969 e lëshuar nga ky Universitet. Këto të dhëna janë në përpushtimë edhe me Diplomën e paraqitur fizikisht në Këshillin e Etikës.

Në lidhje me origjinalitetin e Disertacionit të Doktoratës me titull: "Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë" të kandidatit Prof. Asoc. Dr. Avni Puka të mbrojtur në Universitetin e Prishtinës në vitin 2016, Këshilli i Etikës ka konstatuar se për këtë çështje nevojitet një dije specifike e fushës së ngushtë juridike dhe kërkuar angazhimin e ekspertëve profesional për hartimin e një ekspertize. Për më tepër, meqenëse pala parashtruese Prof. asoc. Dr. Avni Puka kishte qenë edhe bartës programi në Fakultetin Juridik, Doktorata e tij ka kaluar edhe nëpër filtrat e vlerësimit të Agjencisë Kosovare për Akreditim (AKA). Dhe në lidhje me këtë, ka kërkuar informacion edhe nga kjo Agjenci në lidhje me dosjen e z. Avni Puka.

Me datën 08.11.2023, Këshilli i Etikës me Vendim nr. 2/789 ka emëruar: Prof. Dr. Ejup Sahiti dhe Prof. Dr. Rexhep Murati, në cilësi të ekspertëve profesional për të bërë ekspertizë profesionale përkitazi me atë nëse janë respektuar standardet shkencore për një punë shkencore si dhe origjinaliteti i punimit të doktoratës me titull: "Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë" të

L. M.

Prof. Asoc. Dr. Avni Puka, të mbrojtur në Fakultetin Juridik të UP-së në Prishtinë me datë 08.09.2016.

Me datën 09.01.2024, është dorëzuar Raporti i ekspertimit me shkrim me Nr.prot.01/55 i dy Ekspertëve.

Raport i Ekspertizës fillimisht thekson rëndësinë e temës së trajtuar në disertacionin e doktoratës së kandidatit A. Puka, si dhe konstatohet se: "... teza e doktoratës me titull: "Përgjegjësia penale e personave juridikë" e Avni Pukës trajton një institut juridik rishtazi të rregulluar. Sa dimë ne ky punim paraqet një nismë të parë në Republikën e Kosovës sa i përket trajtimit teorik të përgjegjësisë penale të personave juridikë."

Në vazhdim të Raportit të Ekspertizë paraqitet struktura e punimit të doktoratës, si dhe duke theksuar se "Mënyra e tillë e mbarshtrimit të materjes për trajtim, punimin e karakterizzon si studim serioz dhe të pavarur." Gjithashtu, theksohet edhe "...se vlera e një punimi shkencor, veç tjerash, matet me literaturën e shfrytëzuar. Në këtë drejtim kemi vërejtur se autor i Puka shfrytëzon literaturë të gjerë nga autorë të huaj, me ç'rast nëpërmjet aparaturës shkencore përkatesisht sistemit të fusnotave rregullisht paraqet në mënyrë konkrete dhe preçize burimin e shfrytëzuar. Sa për ilustrim theksojmë se disertacioni i Avni Pukës ka rreth 90% të burimeve të cilat janë të ndryshme nga burimet e paraqitura në tekstinn e Dr. Av. Ersi N. Bozheku dhe Prof. Dr. Ismet Elezi në veprën: "Përgjegjësia penale e personave juridikë" (në tekstin e mëtejm: Bozheku-Elezi, PPPJ 2012). Kësisoj në tekstin e doktoratës së Avni Puka me vëllim prej 217 faqesh të shkruara në rradhor të mesëm ka 802 fusnota, ndërsa në librime Bozheku-Elezi, PPPJ 2012 me 274 faqe ka 297 fusnota".

Në vijim të vlerësimit dhe krhasimit të disertacionit të Prof. Puka në relacion me literaturën e ngjashme të autorëve shqiptarë, Raporti i Ekspertizës thekson se:

"Marrë në përgjithësi, krahasimi i tekstit të doktoratës së Avni Pukës me tekstin e Bozheku-Elezi, PPPJ 2012; pastaj krahasimi me burimet e tjera të shfrytëzuar; testimi elektronik i disertacionit përmes sistemit antiplagjiaturë, duke e kontrolluar me softuer-in (AI) "PlagiarismCheck"; si dhe duke pasur parasysh edhe stilin e shkrimit, mënyren e argumentimit dhe burimet e konsultuara del se disertacioni nuk rezulton me ndonjë kopjim apo parafrazim i cili do ta vënte në pikëpyetje origjinalitetin e tij. Autori Puka për çdo shfrytëzim të literaturës, duke i respektuar standarde e punës shkencore, të drejtën e autorit dhe etikën në hulumtim, vazhdimishti referohet burimit nëpërmjet sistemit të fusnotave. Andaj, mbështur në konstatimin e mësipërmduel përfundimi se doktorata e autorit Avni Puka është origjinale dhe në pajtim me standarde përpunë kërkimore-shkencore."

Në fund, ekspertët parqesin Mendimin profesional, si në vijim:

"Pas gjithë asaj që konstatuam më sipër, Këshllit të Etikës të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" i paraqesim MENDIM – in se: Teza e Doktoratës e Prof. Asoc. Dr. Avni Puka me titull: "Përgjegjësia Penale e Personave Juridikë", e mbrojtur në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë në vitin 2016, është punim

*origjinal i pavarur, në të cilin janë respektuar standartet profesionale dhe etike për punë kërkimore shkencore.”*

Me datën 18 janar 2024 nga Prof.Asoc.Dr. Avni Puka është dorëzuar në dy kopje disertacioni i doktoratës në Këshillin e Etikës.

Me datën 24.01.2024, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka ofruar Përgjigjen përmes shkresës me nr.prot. 69/240.

Në përgjigjën e AKA-së, konstatohet se Prof.asoc.dr. Avni Puka ka bërë deklarimin në sistemin elektronik E-Akreditimi dhe në këtë dosje ka doktoratën, vendimin e Senatit, Kontratën e punës, punimin e doktoratës dhe punimet shkencore të indeksuara në WoS dhe Scopus, si dhe deklaratat nën betim 2019-2023. Tuje në shkresën e AKA konstatohet se:

*“Në pajtim me kompencat dhe sipas praktikave që zbaton AKA respektivisht organi i saj vendimarrës –Këshilli Shtetëror i Cilësisë, për të gjithë personelin akademik të deklaruar në E-Akreditimi, dosja e Prof.asoc.dr. Avni Puka është verifikuar në tërsi dhe rezulton se doktorata, punimet shkencore dhe dokumente e tjera janë në pajtim me standartet që zbaton AKA.”*


*Për me tepër, Fakulteti Juridik i UP-së, në tetor të vitit 2022, ka aplikuar në AKA për programin “E drejta penale LLM”, ku bartës i programit ka qenë profesori Avni Puka. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) e ka shqyrtuar komplet dokumentacionin e profesorit Puka dhe e ka konstatuar se ai i plotëson kriteret për të qenë bartës i programit, duke përfshire diplomën PhD, fushën e studimit dhe publikimet e indeksuara në Web of Science dhe Scopus.”*

Në fund theksohet edhe se bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më 13.07.2023 ka vendosur për akreditimin e këtij programi me vendimin Nr. protokolli 1000/23 datë 27/07/2023.

Në lidhje me procesin e avancimit akademik, konkretisht procesin e zgjedhjes dhe avancimit të Prof.Asoc.Dr. Avni Puka në thirrjen e mësimdhënësit/profesorit në Fakultetin Juridik, Këshilli i Etikës ka kërkuar nga instancat vendimarrëse të Rektoratit informata të hollësishme për procedurën e vlerësimit dhe bazën juridike për fitimin e kësaj thirrje akademike.

Me datën 01.02.2024, Këshilli i Etikës në lidhje me këtë proces ka pranuar Shkresën informuase me nr. prot. 354 nga Prorektori për personel akademik, integritet dhe botime i UP.

Sipas Shkresës informuese në fjalë, konstatohet se Avni Puka në vitin 2017 është emëruar në gradën akademike Profesor Asistent në Fakultetin Juridik për lëndët: E drejta penale, E drejta penale – pjesa e posaçme, E drejta penale ndërkombëtare dhe E drejta penale Evropiane, sipas vendimit të Senatit të UP-së, me nr.prot. 1/411, dt.26.05.2017 (*bazuar në konkursin me nr.prot. 3/671 të dt.24.11.2016*).



Këshilli i Etikës nënvizon faktin se në procesin e avancimit akademik, pala parashtruese Avni Puka ka paraqitur Diplomën e Doktoratës të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës si bazë juridike dhe që përben kriter substancial statutar përfitimin e gradës profesor asistent.

Nga Shkresa informuese konstatohet se me datën 29.09.2022, Profesori Avni Puka nga grada profesor asistent është avancuar në thirrjen akademike Profesor i asocuar përlendët e njëjtë (duke respektuar afatin statutar 4 vjeçar përkohëzgjatjen nga thirrja paraprake). Në këtë proces është me rëndësi të theksohet se sipas Raportit të Komisionit Vlerësues në dosjen e aplikimit për thirrjen e Profesorit të asocuar është bashkangjitur edhe Diploma e doktoratës se fituar në Universitetin e Romës “La Sapienza” (Itali), e cila është referencuar nga komisioni vlerësues, por vetëm krahas Diplomës së Doktoratës të UP. Pra, edhe në këtë rast, Diploma e Doktoratës e Universitetit La Sapienza nuk është përdorur si bazë juridike përfitimin e gradës akademike. Gjithashtu, nga shkresa konstatohet se ne të dy proceset (e zgjedhjes dhe avancimit) Profesori Puka ka pas vlerësim pozitiv në të gjitha nivelet (*Komisioni Recensues, Këshilli i Fakultetit Juridik, Komisioni i Studimeve/Trupa Këshilldhënëse e Rektorit dhe Senati*) dhe lidhur me vendimarrjen nuk është evidentuar asnjë ankesë.

Këshilli i Etikës ka shqyrtuar me kujdes faktet e prezantuara dhe provat e parashtruara nga pala e interesuar. Në këtë proces të administrimit të fakteve dhe provave janë involvuar edhe institucionale relevante kombëtare dhe ndërkombëtare, siç janë Universiteti i Prishtinës dhe organet e tij, Agjencite e pavarura institucionale si dhe vetë Universiteti i Romës në Itali.

Këshilli i Etikës ka vlerësuar këto fakte dhe prova të parashtruara secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka arritur në përfundimin se çështja e parashtruar mund të vendoset meritorisht. Faktet dhe provat e prezantuara nga ana e institucioneve përkatëse publike janë të padiskutueshme dhe gjëzojnë prezumimin e vërtetësisë absolute. Këshilli i Etikës ka shqyrtuar poashtu ekspertizën profesionalë dhe vlerëson atë ekspertizë të argumentuar dhe të besueshme. Rrjetimisht, Këshilli i Etikës ka marr në konsideratë këto fakte të prezumuara ligjore dhe ka arritur në përfundime të dhëna me dispozitiv.

### III. Përfundimi

Duke marrë përbazë të gjitha rrëthanat e rastit në tërësinë e tyre faktike dhe ligjore, dhe në veçanti kompetencat dhe detyrat, Këshilli i Etikës të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në emër dhe me autorizimin e Këshillit të Etikës



Prof. Dr. Iset Morina  
Kryesues